



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 223/5 Prot

Tiranë, më 24.7.2024

VENDIM

PARALAJMËRIMI

Nr. 45, datë 24.7.2024

“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Peqin dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e situatës së ligjshmërisë”.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në institucionin e vetëqeverisjes vendore Bashkia Peqin,

VËREJ SE:

Me urdhrin nr. 39 (223 prot.), datë 21.3.2024, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil në Bashkinë Peqin”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira dhe procedurave disiplinore në shërbimin civil, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Bashkia Peqin.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë realizimit të procedurave disiplinore në shërbimin civil, për periudhën janar 2021 - dhjetor 2023.

Procesi është zhvilluar në përputhje me Programin e Mbikëqyrjes nr. 223/1 prot., datë 21.3.2024, të miratuar nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i cili me shkresën nr. 223/2 prot., datë 21.3.2024, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Peqin”, i është njoftuar institucionit.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Bashkia Peqin dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 223/3, prot., datë 31.5.2024, të Komisionerit, duke i lënë një afat 15 ditë kohë, për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes, me shkresën nr. 1375 prot., datë 10.7.2024, ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje. Së bashku me projektraportin janë dërguar materialet shkresore me të cilat është njoftuar nëpunësja Livia Kateshi, që të dorëzojë dokumentin që vërteton nivelin e arsimit të lartë dhe fushën kryesore të studimeve që ajo ka përfunduar, pasi ky dokument është konstatuar në mungesë gjatë kryerjes së verifikimit në subjekt. Shkresat janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe janë analizuar në pjesët respektive të raportit përfundimtar.

Gjatë procesit të verifikimit, janë vërejtur disa mangësi në drejtim të administrimit të shërbimit civil, të cilat më me hollësi janë vënë në dukje në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, ndër të cilat:

- Institucioni ka hartuar dhe miratuar planet vjetore të pranimit në shërbimin civil, por plani i pranimit nuk është plotësuar në asnjë vit. Për këtë arsye, pozicionet e paplotësuara janë mbartur vazhdimisht në vitin pasardhës, duke përbërë shkak që, numri i pozicioneve të lira vit pas viti të jetë gjithmonë i lartë.
- Në dojen e konkurrimit për pozicionin “*Specialist për Koordinimin Evropian dhe Ndihmën e Huaj*” dhe në dosjen individuale të krijuar për nëpunësen Livia Kateshi, e shpallur fituese për këtë procedurë e më pas emëruar nëpunës civil në periudhë prove, nuk është administruar diploma e arsimit të lartë që ajo zotëron. Për pasojë, nuk vërtetohet nëse ajo i plotëson kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil lidhur me nivelin e arsimit që kërkon pozicioni përkatës, parashikuar nga shkronja “e”, neni 21, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

- Gjatë procedurës së vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, në të gjitha rastet, rezulton se nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër në detyrë dhe për këtë arsye, mungon mendimi me shkrim i tij.
- U konstatuan nëpunës që iu ka përfunduar periudha e provës, e cila zgjat një vit nga data e aktit të emërimit, por për këto raste nuk ka vendim të eprorit direkt në lidhje me konfirmimin e nëpunësit, zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së provës, apo moskonfirmimin e nëpunësit.
- Gjatë procesit të mbikëqyrjes është konstatuar se në 19 raste, në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil, me akt emërimi të nxjerrë nga titullari i institucionit, janë emëruar punonjës pa u zbatuar procedurat e konkurrimit të përcaktuara në këtë ligji.
- Për disa të punësuar në pozicione të shërbimit civil, në dosjet e personelit, nuk janë përfshirë, të gjitha dokumentet që vërtetojnë të dhënat e përcaktuara në pikën 1, kreu II, të vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të Regjistrit Qendror të Personelit”, si dhe lidhjet 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar për të shprehur pretendimet e tij në lidhje me problematikat e evidentuara.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/ inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar.

V E N D O S A:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, në institucionin Bashkia Peqin, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. Të kërkoj nga institucioni i mbikëqyrur, që për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me punonjësen Livia Kateshi, njësia përgjegjëse e institucionit, të kryejë të gjitha veprimet për verifikimin e dokumentit që vërteton plotësimin e kërkesave të nivelit arsimor në përputhje me përkrahimin e punës. Nëse pas verifikimit, rezulton se nuk plotësohen kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, njësia përgjegjëse të veprojë në përputhje me përcaktimet e nenit 21 e 65 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Të njoftohet Komisioneri për të gjitha veprimet administrative që do të kryhen në këtë rast nga njësia përgjegjëse.

3. Të përmbillet procesi i konfirmimit si nëpunës civil, pas përfundimit të afatit të periudhës së provës, për nëpunësit: *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist në Sektorin e Aplikimit të Projekteve dhe Integritet Evropian” dhe *****, emëruar nëpunës civil në periudhë prove në pozicionin “Specialist për menaxhimin e burimeve njerëzore”, në përputhje me kërkesat e ligjit, sipas detyrave të lëna nga Komisioneri, në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
4. Të kërkoj nga Kryetari i Bashkisë Peqin, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për punonjësit e emëruar në pozicione pune që rregullohen nga ligji për nëpunësin civil në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në këtë ligj, që aktualisht janë **18** raste, të evidentuara nominalisht më poshtë dhe të rregullojë pasojat, me qëllim që në momentin e shpalljes së pozicionit të lirë të punës pranë AKPA, për tu plotësuar nëpërmjet konkurrimit, pozicioni të jetë efektivisht i lirë, për të respektuar në këtë mënyrë parimet e pranimin në shërbimin civil, ndër të cilat parimi i shanseve të barabarta dhe profesionalizmit. Ky veprim do të rivendosë situatën e ligjshmërisë dhe do të mundësojë procesin e rekrutimit sipas kërkesave specifike që rregullojnë këtë institut të ligjit.

Bëhet fjalë për pozicionet e punës, të cilat aktualisht janë të zëna nga punonjës të emëruar përkohësisht, sipas akteve që do të evidentohen në vijim, të nxjerra në kundërshtim me ligjin:

1. *****, emëruar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”, me urdhrin nr. 243 (1907 prot.), datë 30.11.2022, të kryetarit.
2. *****, emëruar në pozicionin “Inspektor i taksave dhe tarifave vendore”, me urdhrin nr. 212 (1653 prot.), datë 19.10.2022, të kryetarit.
3. *****, emëruar në pozicionin “Specialist në Sektorin e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit”, me urdhrin nr. 65 (555 prot.), datë 4.4.2022, të kryetarit.
4. *****, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit për Apelimin e Projekteve”, me urdhrin nr. 82 (723 prot.), datë 4.5.2022, të kryetarit.
5. *****, emëruar në pozicionin “Specialist për Koordinimin Evropian dhe Ndihmën e Huaj”, me urdhrin nr. 134/1 (877/1 prot.), datë 31.5.2023, të kryetarit.
6. *****, emëruar në pozicionin “Inspektor i taksave dhe tarifave vendore”, me urdhrin nr. 183 (1005 prot.), datë 14.6.2023, të kryetarit.

7. *****, emëruar në pozicionin “*Inspektor i taksave dhe tarifave vendore*”, me urdhrin nr. 46/3 (46/3 prot.), datë 12.1.2023, të kryetarit.
 8. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, me urdhrin nr. 46/2 (46/2 prot.), datë 12.1.2023, të kryetarit.
 9. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist në Sektorin për Apelimin e Projekteve*”, me urdhrin nr. 36 (124 prot.), datë 19.1.2023, të kryetarit.
 10. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist Finance*”, me urdhrin nr. 46/1 (46/1 prot.), datë 12.1.2023, të kryetarit.
 11. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist inventaresh*”, me urdhrin nr. 136/2 (879 prot.), datë 31.5.2023, të kryetarit.
 12. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist prokurimi*”, me urdhrin nr. 136/1 (879/1 prot.), datë 31.5.2023, të kryetarit.
 13. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist për mirëmbajtje rrjeti kompiuterik*”, me urdhrin nr. 46/4 (46/4 prot.), datë 12.1.2013, të kryetarit.
 14. *****, emëruar në pozicionin “*Drejtor i Drejtorisë së Mirëqenies dhe Kujdesit Social*”, me urdhrin nr. 176 (976 prot.), datë 13.6.2023, të kryetarit.
 15. *****, emëruar në pozicionin “*Specialist jurist në Sektorin e Ndhmës Ekonomike*”, me urdhrin nr. 23 (98 prot.), datë 18.1.2023, të kryetarit.
 16. *****, emëruar në pozicionin “*Inspektor i taksave dhe tarifave vendore*”, me urdhrin nr. 447/2 (447/2 prot.), datë 4.3.2024, të kryetarit.
 17. *****, emëruar në pozicionin “*Inspektor i taksave dhe tarifave vendore*”, me urdhrin nr. 41 (284 prot.), datë 8.2.2024, të kryetarit.
 18. *****, emëruar në pozicionin “*Arkitekt në Sektorin e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit*”, me urdhrin nr. 447/1 (447/1 prot.), datë 4.3.2024, të kryetarit.
5. Për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me rastin e ngritjes në detyrë në kundërshtim me procedurën e kërkuar nga ligji për nëpunësin civil, të punonjëses *****, e cila me urdhrin nr. 447/3 (447/3 prot.), datë 4.3.2024, të kryetarit, është emëruar në pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Mjedisit, Kadastrës, Aseteve dhe Ndjekjes së Investimeve të Infrastrukturës*”, Kryetari i Bashkisë Peqin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit të emërimit për këtë punonjëse dhe të rregullojë pasojat.

Punonjësja të rikthehet në pozicionin e mëparshme të punës ose në rast të pamundësisë për t’u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës, të bëhet sistemimi në një pozicion tjetër të shërbimit civil, të së njëjtës kategori ku ajo i plotëson kërkesat specifike për vendin e punës.

5. Përsa i përket mangësive të konstatuara nga verifikimi i akteve të depozituara në dosjen e personelit, të merren masa nga ana e Njësisë së Burimeve Njerëzore, të plotësohen në rregull sipas përcaktimeve ligjore dhe në përfundim të administrohen në dosjen përkatëse:
- Për rastet kur punonjësit nuk kanë depozituar diplomën dhe listën e notave origjinale ose të noterizuar, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, por kanë depozituar vetëm vërtetime të

lëshuara nga Institucionet Arsimore ku kanë kryer studimet dhe bëhet fjalë për nëpunësit: ***** , ***** , ***** , ***** , ***** , dokumentet e depozituara në dosjet e personelit, duhet të jenë: a) origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri, dhe b) dokument të barasvlershëm me diplomën në formën e vërtetimit, që duhet të përmbajë: i) emrin e institucionit që ka lëshuar diplomën, ii) numrin e diplomës origjinale, iii) datën e lëshimit të saj, iv) ciklin dhe programin e studimit.

- Për rastet e evidentuara me mungesa të raportit mjekësor, të plotësohet dosja e personelit me këto akte, sipas kërkesave të ligjit.
- 6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **3 (tre) muaj** nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim, duke u bazuar në orientimet e dhëna në raportin përfundimtar.

Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, duke dërguar edhe aktet që vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna.

- 7. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Peqin, Prefekti i Qarkut Elbasan, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

Njësia Përgjegjëse e Bashkisë Peqin, duhet të njoftojë për këtë vendim, çdo punonjës që është i emëruar në kundërshtim me ligjin si dhe çdo subjekt tjetër i cili është ngarkuar me detyra të posaçme, në raportin përfundimtar dhe në pjesën arsyetuese të këtij vendimi.

- 8. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, nga subjektet përkatëse, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjositjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha